Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 567/01
Datë 11.12.2014

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/14- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 11.12.2014 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për riakreditimin e Qendra e Zhvillimit dhe Trajnimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës në Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare, 11. 12. 2014 deri 11.12.2017 për:

1.1. Gjuhë angleze

Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

1. T'u ofrojë mësimdhënësve të gjuhës angleze trajnim për zhvillim profesional (konferenca, kurse online, etj.) dhe të sigurojë dëshmi për ndjekje të trajnimeve të ndryshme
2. Të përpilojë dhe zhvillojë politika dhe rregulla për sigurim të cilësisë në praktikë që përfshin vrojtimin e rregullt të mësimdhënësve nga ana e Koordinatorit të Cilësisë dhe vrojtimin e mësimdhënësve nga kolegët.
3. Certifikata e përfundimit të nivelit duhet t'i referohet kompetencave gjuhësore të kandidatit të përshkruara sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (KPERGJ)
4. Testi përfundimtar për çdo nivel duhet të jetë në harmoni me kompetencat e përshkruara sipas KPERGJ-së

Afati kohor për plotësimin e të gjitha këtyre kushteve është 31.05.2015

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 13.11.2014, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Raportin e Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
Raporti i Vetë-vlerësimit;
Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:
   - QTZH- PTK; dhe
   - AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi